



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 59

Datë: 01. 11. 2017, ora: 15:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi dhe Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP; Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.58/2017
2. Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të 22 Tetorit 2017, për Kryetar të Komunave;
3. Raport nga Sekretariati (raport nga QNR);
4. Ndryshim plotësimi i Planit Operativ të Sigurisë, për zgjedhjet lokale të Raundit të dytë për Kryetar Komune
5. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.58/2017

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve, s'i në vijim e kemi përpara shqyrtimin e procesverbalit nga hera e kaluar si dhe shqyrtimin dhe plotësimin e planit operativ të sigurisë për Raundin e Dytë. A ka dikush vërejte...? Nëse jo, kush është për...?

Pika tjetër: procesverbali i mbledhjes së fundit. A ka dikush vërejte...?

Anëtarët e KQZ miratuan në mënyrë unanime rendin e ditës.

Betim Gjoshi: Kryetare, është mirë me tregue se KQZ i ka votuar rezultatet zgjedhore në mënyrë unanime...!

Vldete Daka: Po, le të plotësohet kjo...

Anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr.58/2017

Betim Gjoshi: Edhe diçka: I përgëzoj kryetare se, procesverbalet se po na sjellin shpejtë ngase, edhe jemi në proces zgjedhor...!

Valdete Daka: Vazhdojmë raporti nga sekretariatin

2. Raport nga Sekretariati (raport nga QNR)

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju njoftoj se Qendra e Numërimit të Rezultateve, është në procesin e futjes së të dhënave për subjekte politike dhe kandidatë për zgjedhje në kuvendin e komunës pra për zgjedhjet për kuvendin komunalë, ky proces nuk ka mundur të kompletohet për arsyeje një numër i vendvotimeve dhe një numër i fletëvotimeve, nuk kanë mundur të kalojnë auditimin për shkak të problemeve përmes postes në votat e kandidatëve. Arsyeja: kandidati ose kandidatja, ka ma shumë vota se sa subjekti, dhe kemi edhe raste kur subjekti ka më shumë se kandidatët dhe rastet e kundërta, kur kandidati ka vota dhe subjekti ka vota. Para jush, janë 2 tabela, njëra është nga raporti i auditimit për Kuvendin Komunalë që ka me vete 524

vendvotime të cilat, nuk kanë mundur të kalojnë një numër i tyre nga raporti, mirëpo edhe në rastet e tjera edhe në numrin e tyre, janë 196 që në vendvotimet që kanë nga një votë. Por, sistemi nuk e pranon asnjë nga subjekti, për nga kandidatet kemi edhe rastet e tjera kur i kemi nga dy vota, i kemi edhe tabelat nga ky raport i plotësuar, dhe i kemi të gjitha rastet se sa vota është diferenca, dhe se sa vendvotime. Në total, janë gjithsej 524 vendvotime, prej tyre 52 vendvotime kanë mospërputhjen me formular të futjes se të dhënave, ndërsa 640 vendvotime kanë mospërputhje, Bashkangjitur e kemi edhe një raport tjetër, se QNR e bënë edhe filtrimin në raste kur subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota. Kriterin e kemi marrë kur subjekti i ka 3 vota dhe kandidatët kanë 0 vota, dhe kjo rezulton prej tyre prej 221 vendvotimeve që janë të listë. Është numri i votave të cilat subjekti i ka votat, dhe kandidatët kanë 0 vota, dhe numri total i tyre është 221, mirëpo 53 vendvotime nga 24 fletvotime, gjithsej 163 fletvotime, që në total janë 592 vendvotime të cilët nuk kanë mundur të kalojnë, dhe të thotë 52 prej tyre janë për Kuvend Komunal, janë formularët për të futjen e të dhënave të rezultateve me mos përputhjen të fletvotimeve edhe të votave. Te subjektet, 640 vendvotime kanë mos përputhje me votat e kandidatëve. Pra, kjo është gjendja e tyre që është para jush edhe raporti dhe për këtë nevojitet miratimi edhe nga KQZ që procedohet ma tutje rekomandimi nga qendra e rezultateve. Të gjitha këto, të rinumërohen për arsye se nuk mund të kalohet më tutje, pra nuk e kalojnë auditimin në gjendjen se çfare janë aktualisht, pra gjithmonë nga raporti i auditimit.

Bashkangjitur janë edhe tabelat me 524 vendvotime, tha z. Ahmetaj, dhe e kemi edhe tabelën e dytë që është me 168 vendvotime, pra thash edhe më herët se janë 53 vendvotime, dhe janë edhe në këtë tableë...

Adnan Rrustemi: Në radhë të parë, pajtohem me rekomandimin e QNR-s që t'i numërojmë këto 692 kuti. Kisha nevojë për këto sqarimet dhe ta plotësojë Burimi lidhur me atë se, sa prej tyre janë edhe në kategorinë e parë, se sa janë edhe në kategorinë e dytë. Gjendjen reale e kemi, dhe nga ky moment t'i rinumërojmë...Na duhet të reflektojmë mbi këtë gjendjen të fletë votimit për secilin kandidat. Kjo, bëhet edhe ma e rëndësishëm nga zgjedhjet lokale për asambleistët që mund të jenë në garë për një votë të vetme që mund të jetë përcaktuese në aspektin e përgjithshëm dhe unë e shprehim si shqetësim në vazhdimësi përball rinumërimit, të cilët po e damkosin procesin zgjedhor. Në secilin proces, ne përballemi me situata të tilla ku qindra kuti dha nga 1/3 here edhe ma shumë shkojnë në rinumërim. S'po i përjashtojmë këto, dhe të tjerat që eventualisht shkojnë në rinumërim për shkak të ankesave që bëjnë kandidatët në PZAP.

Përshtetshëm, tha z. Rrustemi, ky model i numërimit të votave për mua, po dëshmohejt se nuk është efikas edhe produktiv përkundër adresimit për trajnim dhe, përkundër masave të

ndërmarrë në thjeshtimin e të dhënave të votimit për asamblist...dhe sidomos për faktin se kanë pasur mundësi me e votue vetëm për një kandidat dhe jo si ma herët 5 kandidat...Rrjedhimisht, edhe numërimi ma i lehtë ka qenë, thjeshtë ne jemi në një situatë të tillë, nga 700 fletëvotime dhe 700 kuti duhet që t'i rinumërojmë...Duhet të kërkojmë ndryshim të mënyres së numërimit të votës...Për mendimin tim, duhet me i bartë të vendvotimit edhe formularët e numërimit të votës në Qendrat e Perqëndrueme në mënyrë transparente nga ekipet tjera, o duhet me i ndrruar ekipet e tjera për rinumërim, përveq ekipit ditorë sepse, se kjo edhe po e zvarrit procesin edhe po e dëmton integritetin e vendit...

Betim Gjoshi: Kryetare, nëse me lejohet. Është fat i mirë që ne po organizojmë zgjedhje jashtëzakonsht të mira edhe në këtë fazë, të mira me të gjithë aktortë të kyqur në proces, sidomos të partive politike e të cilat, munden me e ndreqë ose me prish më shumti procesin...Është fat i mirë po ashtu që ne mundemi me e miratuar por, po presim sepse në rend të dites e kemi certifikimi e rezultateve për Kryetare të Komunës. Dhe nuk kemi pasur as një ankesë, dhe procesi ka shkuar mirë për sa i përketë votave për kandidatët si në zgjedhjet e përgjithshme si për kandidatët për zgjedhje lokale...Mirëpo, kemi pasur problem të vazhdueshme dhe kjo nuk duhet me na kënaq, se është e domosdoshme që me ndërmarrë masa dhe unë e shohë se duhet reformë zgjedhore, dhe se nëse s'ka reform zgjedhore është mirë me marr masa...Për fat te keq, kjo nuk është mirë dhe se ne duhet njëmend të kërkojmë rrugë, forma për të gjetur zgjidhje...Nëse nuk ka reformë, kishte qenë e mundur me e caktuar një person, një sekretar që e i mbushë formularët pra, që e merrë përgjegjësinë dhe procesi bëhet më transparent...Por sot jemi në situatë kur rreth 700 kuti shkojnë në rinumërim...Ne duhet të pajtohemi me këtë dhe që vullneti i qytetarit të sillet në vend! Po mundohemi që edhe vullneti i kandidatëve për asamble dhe i subjekte politike të shkojë në vend dhe që atyre t' hiqet brengën rreth procesit të numërimit të votave edhe për këtë kërkoj nga QNR që me pas transparent sa ma ta madhe që me të vëretet me shkue vota ku e kan deshiruar qytetaret e vendit. E dyta, është mirë që në vendim m'u permisuar numri total i kutive që numërohet se, dikun shkrun 52, e dikun ndeëlidhet me 53...

Mendoj që është mirë procesi me qenë sa më transparent, me i bërë transparent formularët e rezultateve ngase, ka rezultate të ngushta edhe te kandidatët por, prapë shkon me nje numer ma të madh, dhe se 1670 kutitë e tjera që po procesohet si të rregullta edhe ato ndoshta kanë mundur me pas ndonjë problem.

Kam një pyetje për Burimin, është për një vendvotim dhe një kërkesë që ka qenë me shkrim por që më vonë nuk e gjeta, është fjala për vendvotimin 817C në 01R për asamble, e jo për

kryetar...Ju kanë bart prej subjekti me numer 94 në ato te 86, nuk e gjeta në listë numrin dhe se, sa për verifikim ka qenë mirë me e rregulluar...

Burim Ahmetaj: Në ato raste kur nuk është e faktume prej fletës sëpunës, edhe kur është bërë bartja gabimisht e të dhënave, ne në ato raste i përmirësojmë në bazë të procedurave. Në rastet kur është e faktume në fletë të punës nuk kemi kurrfarë procedure me ndërhy kështu që konsideroj që ndoshta mund të jetë në mesin e tyre.

Valdete Daka: Faleminderit Burim. Po Binak....!

Binak Vishaj: Faleminderit kryetare. Sistemi i menagjimit të komunave në Kosovë, është sistem presidencial në një mënyrë, gara bëhet për kryetar të komunave. Ne e kemi dhënë rezultatin përfundimtarë dhe sot, sa e di unë kemi vetëm 4 ankesa që janë bërë për procesin e garës për kryetarë të komunave që i bjen është një arritje e madhe mirëpo, po kem problem prap te numërimi votave për kandidat kjo e bënë të nevojshme ose formës zgjedhore ose ndërhyrjen në këtë pjesë që ose të qendrave regjionale të numërimit ose qendrave komunale të numërimit sido qoftë unë e përkrahi këtë rinumërim por, e ftoj Burimin të bëjë publikimin e këtyre formularëve në mënyrë që këta formular të jenë adresë e ankesave dhe për kandidatë të cilët janë të gatshëm duke i prit rezultatin e mundet të jetë adrës e ankesave i njëjta kuti që nëse e sheh pasqyrimin e rezultatit atëherë nuk ka me pas nevojë mu anku se ka me pas të qartë pasqyrën se cili është realiteti pas rinumërimit në kuti. Faleminderit. Se mundet me qenë objekt ankese në dy rastet.

Sami Hamiti: Realisht, shumicën e çështjeve që u ngritën edhe u thanë këtu nga të gjithë përfaqësuesit e partive politike po e shoh këtu që edhe nga kryetarja që ka nevojë për reformë zgjedhore. Është e vërtetë që një numërimi në vendvotim dhe çështja e përbërjes së këshillave dhe vendvotimeve nga përfaqësuesit e partive politike, dhe këtu po del që kemi probleme dhe realisht, duhet të punohen nga partitë politike që sa më shpejtë të shkohet dhe të bëhet reformë në Ligjin e Zgjedhjeve dhe të bëhet një çështje regjionale e regjionit apo e komunës ku do të numëroheshin ato vota. Thjeshtë, përbërja e Këshillave të Vendvotimeve të mos jetë prej përfaqësuesve politik, në këtë rast po them se më mirë është të jenë punëtor administrativ a shtetëror, ose këtë që e propozoi Betimi të ketë bile një sekretari i këshillit, të jetë një punëtorë i cili e merr përgjegjësinë...Sepse, në këtë rast opinion po konsideon që problem është te KQZ-ja ose të Qendra e Numërimit...

Jo, tha z. Hamiti, problemi ka ndodh në vendvotime dhe pikërisht ka ndodh nga komisionarët që janë përfaqësues të të gjitha partive politike kjo. Kështu që unë e përkrahi çështjen e rinumërimit, dhe jam për atë që të shkohet sa më shpejtë në reformë zgjedhore.

Betim Gjoshi: Ndoshta, e kanë testuar rinumërimin e këtyre rreth 700 kutive duke e pa që është një parti, një kandidat është më e lehtë dhe procedura...A keni mundur me bërë ndonjë plan...?

Burim Ahmetaj: Faktikisht, e kemi bërë një planë dhe një përgatitje dhe jemi të gatshëm në vendimi ne KQZ-ës për të vepruar sa i përketë rinumërimit dhe kemi një planë paraprak që e kemi bërë konsiderojmë që brenda një ndërrimit 8 orësh të numërohen dikund 60 vendvotime që i bije brenda ditës dikund 120 vendvotime plus minus mund të numërohen brenda ditës. Do të punojmë dy nderrime për shkak se ndërrimi i tretë ne nuk kemi fort kapacitete dhe mund të jetë pak më jo kredibil.

Betim Gjoshi: Votat me kusht për asamble a janë numëruar...?

Burim Ahmetaj: Jo, nuk janë numëru sepse kemi pritur ndonjë vendvotim që ndërlidhet me votat me kusht për asamble komunale ndoshta mund të ketë efekt. Pra, kjo është arsye pse nuk janë numëru votat me kusht deri më tash për shkak të këtyre vendvotimeve që kanë qenë në auditim, dhe kanë pas probleme me vota. Sigurisht që pas këtyre rinumërimit, atëherë do të kemi gjendjen faktike për secilin vendvotim. Edhe një përgjigje sa i përket skanimit. Gjithmonë pas rinumërimit, bëhet publikimi i të gjitha atyre formularëve të rezultateve, po ashtu, do t'i skanojmë do ti publikojmë në ueb faqen e KQZ-ës për secilin vendvotim dhe për secilën komunë kur të rinumërohen.

Binak Vishaj: Ne, në zgjedhjet e kaluara e kemi pas një numër të vendimeve të Panelit Zgjedhor që e ka marrë për kutitë të cilat, kanë qenë të rinumëruara edhe kjo është e mirë e dyanshme edhe për panelin zgjedhorë edhe për kandidatë që potencialisht, kanë mundur me bërë ankesa për një kuti, se, ne ua dërgojmë atyre kutitë që janë të rinumëruar dhe e marrin rezultatin e ri...Kjo, na ndihmonë edhe neve që me pas një numër më të vogël të ankesave në rast se, janë kutit e njëjta target i ankesës...

Adnan Rrustemi: Po pajtohem me atë që e tha Binaku. Po, është shumë mirë që mos me u përsërit aktiviteti i njëjtë për kutit e njëjta por, një pyetje teknike e pata për m'u siguruar se a

janë përfshirë në rinumërim edhe rastet kur subjekti politik ka pasur vota, ndërkohë kandidatët nuk kanë pasur asnjë votë se, janë disa raste... Shumë mirë që kjo janë disa raste që janë paraqitë dhe janë lajmëruar nga komisioner të caktuar që ka ardh si rezultat edhe i gabimeve, por, ne duhet me pas parasysh d.m.th. që këto rinumërimet si të themi kanë edhe motive të ndryshme edhe shkaqe të ndryshme, diku janë mbase shumica dërmuese janë si të gabimeve aritmetike gati se teknike por ka pas edhe raste kur përbërja mund të jetë si të themi e dyshimit. Unë, thaq z. Rrustemi, kërkoj nga QNR-ja që dy qështje e para, këtë punën e skanimi të formularëve nuk e di qysh keni mujt me organizuar që me ndodhë rinumërimi i secilës komunë së paku kushtimisht, po e them në të njejtën kohë, do të thotë që jo Gjakova me u kry brenda një dite, jo tri kuti të Gjakovës sot dhe tri apo pas katër ditëve se, duhet me u përmbyllë ajo komunë që fillon, m'u përmbyllë së paku sa më shpejtë që është e mundur dhe, mundësisht këta formularë me u publiku brenda dy ndërrimeve. Do të thotë dikun brenda nja 5-6 ditëve ne, duhet me përmbyllë këtë rinumërim. Janë 120 kuti në ditë ditë, dhe 700 i kemi...dhe, së paku 5 ditë na duhen me prit deri në fund. Dhe e dyta, është mirë me na e përgatitë një listë të këtyre Këshillave të Vendvotimeve, respektivisht të Komisionerëve me një vlerësim edhe të shkallës së gabimit ose të dëmtimit për me konsideruar pastaj edhe adresimin eventual në prokurori...

Valdete Daka: Faleminderit Adnan. Fatkeqësisht, kjo po na përsëritet kjo storie disa herë...

Burim Ahmetaj: Sigurisht që do ta përgatisim listën pra, i kemi rezultatet që i kemi shtinë bazë të dhënave të cilat i konsideron rezultate origjinale qfarë na kanë ardh prej vendvotimeve dhe i kemi tash rezultatet të cilat do te prodhohen pas rinumërimit sepse do të krijohen formularët të ri të rezultateve. Edhe ndoshta kish qenë mirë që edhe PZAP-i ta vëzhgojë procesin e rinumërimit sepse i kemi ftuar të gjitha subjektet politike të gjitha organizata mirëpo ndoshta edhe PZAP-i nuk kish qenë keq me qenë aty.

Betim Gjoshi: Ndoshta për opinion, është me rëndësi që të gjitha kutitë që po i qojmë në rinumërim, janë për shkak të kandidatëve dhe nuk ka për shkak të partive...

Valdete Daka: Konstatim i përgjithshëm është se, ajo qka ka ndodh me 22 tetor ka qenë që zgjedhjet janë organizuar mundemi me thanë në superlativ, ndërkaq numërimi në fund të ditës e ka zbeh plotësisht këtë proces të mirëorganizuar dhe, kjo po ndodh pa fajin e KQZ-së dhe pa fajin e subjekteve politike. Kjo, kryesisht po ndodh me fajin e komisionerëve të subjekteve politike dhe të kandidatëve. Po indirekt, janë komisionerët në pyetje ata që po na sjellin

gjithmonë kokëqarje edhe për shkak të cilëve, vonohen proceset me ditë të tëra me javë të tëra vonohen shpalljet e rezultateve dhe konstituimi i asambleve, e që kjo i kushton shtetit shumë...

Kush është për këtë rekomandim? Faleminderit...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e QNDR-së

Valdete Daka: Me siguri që në fund të këtij procesit, Burimi do të na jep edhe numrat dhe do t'i kemi edhe emrat e komisionerëve aty ku ka dyshim që nuk ka gabime të teknike apo njerëzore këta emra gjithsesi do ti dërgojmë në prokurori të shtetit. A kemi diçka tjetër...?

3. Ndryshim plotësimi i Planit Operativ të Sigurisë, për zgjedhjet lokale të Raundit të dytë për Kryetar Komune

Valdete Daka: Është plan që ka qenë në pjesën e parë në raund të parë, janë vetëm ndryshimi i qendrave të vendvotimit dhe njoftimi për fushat ma herët ka qenë 72 orë tash është bërë një ditë edhe këto vlerësimi i qendrave 7 ditëve nuk ka ndryshime dhe besoj që i përshtaten formatit të balotazhit.

Valdete Daka: Kush është për këtë ndryshim...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan Ndryshim plotësimi i Planit Operativ të Sigurisë, për zgjedhjet lokale të Raundit të dytë për Kryetar Komune...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
